

**PROKURORISË THEMELORE NË PEJË**  
**Departamentit të Përgjithshëm**

PEJË, KOSOVË - REPUBLIKË KOSOVË		PROKURORI I INSTITUTIT - ORGANI PËRZUELE	Prokuroria Themelore	Osnovno Tuzilashës
Pranuar 26 DEC 2024				
PLA - PEC				
Nomer i rremës	Rredzi origjinal	Zgjidhje e përmesur	Rezultati i përmesur	Rezultati i përmesur

Në kuptim të nenit 80 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, unë Qendrim Elshani (nipi i Demë Elshanit) nga Fsh. Ozdrim, K. Pejës, në cilësi të palës së dëmtuar paraqes këtë:

**KALLZIM PENAL**

Kundër:

Enver Buqku, Jeton Buqku dhe Egzon Buqku, që të gjithë nga Peja

Sepse:

Me datë 22.09.2023, Enver Buqku dhe Egzon Buqku, si dhe me datë 25.09.2023, Jeton Buqku, në Prokurorinë Themelore në Pejë – Departamenti Për Krimë Të Rënda, në një çështje penale, në cilësi të dëshmitarëve, edhe pse dëshmitarë nën betim, kanë dhënë deklarim të rrejshëm, ashtu që të njëjtë, duke qenë të vetëdijshëm e me qëllim të shmangjes së obligimit – kthimit të borxhit të cilin ia kanë Demë Elshanit dhe familjes së tij dho atë në shumë të konsiderueshme, fillimisht kanë inskenuar raste penale ndaj familjes së tyre, e pastaj kanë deklaruar rrejshëm se nuk kanë pasur kontakt me Demë Elshanin që nga viti 2010, duke e fshehur të vërtetën edhe për raportet mes tyre por edhe duke pas për qëllim që përmes procedurave të rregullta t'ju ikin përgjegjësisë së borxhit, si dhe ta ngarkojnë të njëtin me vepër penale, ashtu që në bashkëkryerje dyshohet që kanë kryer veprën penale

- Deklarimi i rremës nën betim nga neni 383 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

**Arsyimet**

Familja Buqku, konkrektisht Enver Buqku, por më tepër djemtë e tij Jeton dhe Egzon Buqku, duke qenë në raporte shoqërore me Demë Elshanin dhe familjen e tij dhe ate që nga viti 1997 që kur Dem Elshani kishte ardh nga Zvicra me qe ishin komish, vetem një mur i ndante keto dy familje prej kohes qe Enver Buqku e kishte blerë ketë parcele fqinje me Adem Arif Elshanin babgjyshin e Demes, në vazhdimësi kanë marr borxh në para, në shuma të konsiderueshme nga Demë Elshani dhe familja e tij, nga fshati Ozdrim, K. Pejës, e cila vlerë e borxhit në total arrin shumën prej afro 2 Milion euro.

Unë vazhdimisht jam sulmuar dhe kërcënuar nga të njëjtë persona, të cilët kanë organizuar edhe vërjen e zjarrit të veturave të mijës në oborrin e shtëpisë time, pikërisht në fsh. Ozdrim, K. Pejë. Sapo janë djegur veturat, vet Egzon Buqku më ka kërcënuar përmes Alban Dizdarin i cili më ka përcjellë së bashku me disa persona të tjera, ndërsa Jeton Buqku më ka kërcënuar përmes babait

duke ju thënë se sa tē ketë kontakt Qëndrimi me Demë Elshnair ka me pas probleme me neve, se vetëm Qendirmi ka mbet në krahun e Demës nga tē gjithë Elshanët, eshtë i vërtmi që e përkrah.

Pikërisht në ditën kur më eshtë djegur vetura, Egzon Buquku më ka provokuar në rrugë duke më tejkaluar dhe përcjelle pas, me qëllim që të provokohem dhe të reagoi. Dhe në mbrëmje më janë djegur vëturat. Në sistemin e njëjtë, jam përcjelle në vazhdimësi nga Alban Dizdari, i cili më përcjellë pas me disa persona të parnjohur.

Pasi që më digjet vetura pikërisht në shtëpinë time vjen Naim e Sokol Elshnai dhe në prezencë të babait tim [REDACTED] dhe vëllait [REDACTED]. Nami me thotë se derisa kë kontakt me Demën kurrë rahati nuk kë me pas edhe veç shër kë me pas. Unë ju përgjigja se lajani borxhin migjes, se çka eshtë e migjes eshtë edhe e imja. Ne jemi një dhe unë kurrë nuk heki dorë nga migja se ai eshtë burr e trim, ai na ka bo me shpija krejt Elshanve, edhe mu e edhe ty, edhe pa pikë interesë veç pse jemi të afërt, e jemi të një gjaku. Unë i thash Naim Elshanit se ju nuk keni pas as bukë me hongër, bile ty Naim, djalit tond [REDACTED] ja ka pagu edhe ekskursionin, edhe ata dy here se në herën e parë kur ja ka qu paret për ekskursion ka pas thonë mi ka hongër paret mini e ja ka qu për dytën here. Kurrë nuk ja keni la paret e kur nuk ja keni kthy ata çka e ka bo për ju, mixha ju ka pasunu. Ti me djal tondin Leotrimin ia keni vjedh paret, e me qato pare e keni mbaru shpinë e e keni ble edhe vëturën Golf, e edhe plehin e derzhaves. Djali yt në Zvicër le qe e ka vjedh mixhën po edhe firmën e ndërtimit ia ka falimentu bashkë me Buqukt. E qysh mendoni se edhe une mundem me ju bashkëngjitet tradhtive te juaja. Unë ju kam denoncu e se ka ligj e shtet në këtë vend atëherë keni me mëndu ndryshe.

Fillimi, Labinot Lushaj, nga Fsh. Banje e Pejës, nga muaji mars 2009 e deri në vitin 2015, ka qenë në marrëdhënie punc tek i dëmtuari Demë Elshani, në pozitën menaxher i shitjes së makinerisë, makineri të cilat kanë ardhur nga Europa për në Kosovë. Fitimin nga shitja e makinerive, Demë Elshani e përmes Labinot Lushaj, ju ka huazuar shuma të konsiderueshme të hollave familjes Buquku, respektivisht, Jetonit dhe Egzon Buqukit. Enverit

- Në vitin 2009, Jeton Buquku kërkon nga Demë Elshani që ky i fundit, t'ia dërgonte motrës së tij [REDACTED] t dhe dhëndrit të tij [REDACTED] shumën prej 11.000 Euro, si huazim, me arsyetim se ju nevojiten për rregullimin e dokumentacionit – fitimin e leje qëndrimit në Francë. Dema e përbashkët këtë kërkesë të mikut të tij Jetonit, por Jetoni asnjeherë nuk e kthej këtë borxh.

- Me datën 09.12.2012, Labinot Lushaj, ia jep Jeton Buquket shumën prej 5.000 Euro sipas kërkesës së tij, me arsyetim se Jetoni e ka kohën t'ia kthej borxhin një personi – të cilin thoshte se e ka mik, e i cili quhej [REDACTED] (Para këto të familjes Elshani).

- Në vitin 2013, Jeton Buquku ka marr në shfrytëzim nga Demë Elshani gjeneratorin e markës Perkins, ngjyrë e kaltër, në shumë prej 55.000 Euro, të cilin gjenerator as nuk e ka kthyer dhe as nuk e ka paguar. Këtë gjenerator ia ka dorëzuar Labinot Lushaj i cili në atë kohë ishte punëtor i Demë Elshanit, tanë punëtor i Jeton Buqukit. (I njëjtë gjenerator që edhe sot është në funksion pikërisht në fabrikën e Buqukëve në Cig, për çka Jeton Buquku bënë një kallëzim të rrejshëm se kinse dikush ja kishte hedhur një granatë dore pa kapsollë.

- Me datën 12.03.2013, Jeton Buquku i merr nga Labinot Lushaj shumën prej 27.000 Euro, shumë kjo e cila ishte e familjes Elshani, respektivisht Demë Elshanit, me të cilën shumë Jeton Buquku fiton edhe Demë Elshanin që ta shoqeroj për në Valencia me arsyetim se Demë e din gjithën, për çka shkojnë së bashku. Me atë rast, Jeton Buquku blen mish derri dhe të njëjtin e transporton për në Vlorë e pastaj nga Vlora për në Kosovë. Pasi nuk i mjafton shuma prej 27.000 Euro për të bërë pagesën e mishit, Jetoni kërkon që Demë t'ia jep edhe 16.000 Euro të tjera, të cilat Demë ia jep në besim e që në total i bië 43000 Euro.

- Me datën 21.04.2013, Labinot Lushaj nga bugjeti i makinerisë, të cilën ai e menagjonte, ia jap si huazim Jeton Buquket shumën prej 11.900 Euro, që ti paguaj punëtorët, respektivisht pagat. (Para këto të familjes Elshani që kurrrë nuk i ka kthy as ne bilancin e Labinot Lushajt nuk referohen).

- Me datën 02.05.2013 Labinot Lushaj ia jap si huazim Jeton Buquket shumën prej 10.000 Euro me arsyetim që Jetoni ka pas nevojë të furnizohet me mish. Edhe këto nga bugjeti i shitjes së maqinerisë së Demë Elshanit.

- Me datën 15.05.2013, pikërisht në ditën e varrimit të [REDACTED] Elshanit, Jeton Buquku kontakton Demë Elshanin dhe kërkon borxh 20.000 euro me urgjencë me arsyetim se përmbaruesi ka ardh me ju konfisku shtëpinë. Pasi që Demë ishte i angazhuar me procedurat e varrimit dhe këtë shumë nuk e kishte afër vetes, Demë e obligon nënën e tij, [REDACTED] Elshani që të shkon në bankë, dhe ti tërheq mjetet dhe ia jep djalit të motrës së saj, [REDACTED] i cili këtë shumë ia dorëzon Jeton Buquket në dorë. Këtë veprim nëna e Demë Elshanit, përkundër rastin të rendë në familje, e bënë si gjest human dhe ndihmë që shoku i ngushtë i djalit të saj, Demës, mos të mbetet pa shtëpi.

- Me datën 13.06.2013, Labinot Lushaj ia huazon Jeton Buquket shumën prej 5.000 euro, me arsyetim se Jetoni ia kishte borxh [REDACTED], i cili ishte punëtor i Jeton Buquket, si kasap. (Para këto të familjes Elshani)

- Me datën 16.06.2013, Labinot Lushaj ia paguan borxhin e Jeton Buquket në shumën prej 2.300 Euro, një personi me emrin [REDACTED] i cili ishte nga Gjilani, e që ia transportonte Jeton Buquket lopët nga Serbia për në Kosovë, me kërkesën e Jetonit. Edhe shuma prej 2.300 Euro ishin të hollat e familjes Elshani.

- Në vitin 2013, Jeton Buquku së bashku me Labinot Lushaj, Blerim Elshanin dhe Leotrim Elshanin kanë shkuar së bashku në JOUGNE Francë, në parkun e makinerisë industriale e cila ishte në PRONESI të Demë Elshanit, dhe aty Jeton Buquku ka kërkuar nga Demë veturën e llojit Range Rover Sport në shumën prej 90.000 Euro, për të ia dhënë në shfrytëzim derisa ta blejnë një veturë të tyre, me arsyetim se vëllai i Jetonit, Egzoni po ka dëshirë me pas një veturë të mirë, por njëherë nuk po i ka mundësitë me ble. Në këtë veturë, derisa ishte në qarkullim është gjaujtur me armë zjarri Egzon Buquku së bashku me shokun e tij [REDACTED], pikërisht në vitin 2016 nga [REDACTED]

Kjo pasi që Egzon Buquku ia ka therr vëllain [REDACTED] me thikë. Këtë veturë pas kësaj ngjarje e ka dhënë familja Buquku në kombinim, për ndërrim me hotelin Holiday e cila gjendet në Fushë Kosovë.

- Me datë 18.06.2013, Labinot Lushaj, me lejen e Demë Elshanit ia jep Egzon Buqukut shumën prej 2.300 Euro për të lyer veturën Range Rover Sport me arsyetim se dikush ia kishte grithur komplet veturën.

- Me datë 06.10.2013, Labinot Lushaj, pa leje të Demë Elshanit, ia huazon Jeton Buqukut shumën prej 15.000 Euro, dhe me datë 08.10.2013 ia huazon shumën prej 5.000 Euro, për përlaqësim apo pagim të avokatit të Jeton Buqukut, në një procedurë penale, para këto të Demë Elshanit dhe familjes së tij.

- Me datë 12.11.2013, Labinot Lushaj ia jep Egzon Buqukut 1.900 Euro për blerjen e dekoreve të veturës Range Rover Sport, të cilat dekorë do i sjellë dhëndri i Egzonit (burri motrës) i cili jeton në Angli dhe 2.450 Euro për ta lyer përsëri këtë veturë, me lejen e Demës, pasi që Demë pretendonte se veturën do ia kthenin sapo të blejnë veturë familja Buquku.

- Pas kësaj Labinot Lushaj ia dërgon [REDACTED] shumën prej 600 Euro që i njëjti të kryej pagesën e regjistrimit të veturës Range Rover Sport, 150 euro për shikim teknik, 120 euro për tabelat e veturës dhe 110 euro tabelat transitore për me sjellë veturën nga Franca në Gjermani, që pastaj të mundet nga [REDACTED] ta merr veturën familja Buquku.

- Në gusht të vitit 2014 Jeton Buquku, së bashku me bashkëshorten e tij [REDACTED] dhe fëmijë [REDACTED] shkojnë në pushime dy javore në shtëpinë e Demë Elshanit, në Spanjë, që ti kalojnë pushimet së bashku. Pas pushimeve së bashku me Demën – si përkthyes, shkojnë në Valencia, që Jetoni të blenë mish derri në shumë prej 45.000 Euro, të cilin mish e dërgon për në Vlorë dhe nga Vlora për në Kosovë. Pasi që Jetoni nuk mund të bënte transferin e parave, Demë ia huazon këtë shumë, në besim duke besuar se do ia kthente borxhin.

- Në vitin 2015, duke qenë në dijeni Labinot Lushaj që vetura e tipit Volkswagen Featon , pronë e Demë Elshanit, në shumë prej 45.000 Euro , gjendet në shtëpinë e Demë Elshanit, dhe pasi që nënën e Demës e njehnin mirë, Labinot Lushaj së bashku me Jeton Buqukun shkojnë te e njëjtë dhe e kërkojnë duke ju thënë se ju ka thënë Demë me marr, duke e shfrytëzuar mungesën e Demës, dhe besimin e nënës së tij. Këtë veturë kurrë nuk e kanë kthyer dhe kurrë nuk e kanë paguar.

- Në muajin tetor 2015, Egzon Buquku, derisa ishte në qendër të paraburgimit në Gjermani, e telefonon Demë Elshanin dhe e lut që ti angazhon një avokat pasi që është zënë për shpërlaje të parave, për çka Demë e angazhon avokatin Goran Bronisch nga Duseldorf i Gjermanisë dhe e paguan në shumë prej 9.000 Euro, si dhe dorëzanin në shumë prej 30.000 Euro, me arsyetim se sapo të lirohet do ti kthej paratë , pra, shumën e përgjithshme prej 390000 Euro. Nga kjo shumë Egzon Buquku ia kthen vetëm 2000 Euro përmes [REDACTED] ndërsa pjesën tjetër prej 37000 Euro asnjëherë nuk e ka paguar, gjithnjë me arsyetimin se së shpejti do ti kthej.

- Në muajin nëntor 2015, Demë Elshani ia shet [REDACTED] nga Shqipëria kamionin Iveco Trakker 450 Planfiger PK 11000 në shumë prej 190.000 Euro, dhe në muajin dhjetor 2015 po të njëjtët ia shet kamionin DAL LF460 me kran FASSI F435A në shumë prej 85.000 Euro, të cilat shuma me lejen e Demës ia dorëzon Jeton Buqukut, që Jeton Buquku ta paguaj tokën, të cilën e kishte blerë Demë Elshani në Vitomericë, ta përkthente tokën në emër të nënës së Demë Elshanit si dhe me këtë shumë Jetoni ta parcelizonte tokën e blerë, ta bënte instalimin e rrymës,

qëllim me ta asfaltonte rrugën. Nga të gjitha këto, Jetoni nuk përfundoj asnjë obligim, por i përvetësoj këto para përvete.

- Po në këtë vit, Demë Elshani ia shet [REDACTED] Autokrane Grove GMK4100L në shumë prej 450.000 Euro, të cilën makineri Demë e kishte në Rafinerinë e naftës, në Fierë për kompaninë holandeze Shell, me të cilën kompani Demë kishte kontratë. Këtë shumë [REDACTED] ia dorëzon Jeton Buquku me lejen e Demës, që Jetoni këtë shumë ta shfrytëzoj për blerjen e hotelit, tanë të quajtur Holiday i cili gjendet në Fushë Kosovë, dhe të njëjtin Hotel ta përkthente në emër të Demës. (Jetoni këtë Hotel e bleu me pare të Demës, por u shpall vet pronar).

- Në vitin 2016, Jeton Buquku së bashku me Labinot Lushaj dhe Blerim Elshanin, kanë marr gjeneratorin e markës 4Pilar 950kw e cila ishte në pronësi të familjes Elshani, në shumë prej 250.000 euro, e cila ju kishte besuar [REDACTED] në ruajtje, në parkingun e tij, tek rruga e Banjës, duke i thënë se me dijeninë e Demës kemi ardh me marr për shfrytëzim për disa ditë, derisa ta blejnë një gjenerator në Turqi, dhe këtë gjenerator as nuk e kanë kthyer dhe as nuk e kanë paguar, po as nuk e kanë marr me dijeninë e Demës. Për këtë gjenerator jemi në dijeni se Jeton Buquku e ka ndërruar me mish në kundërvlerë të 400.000 Euro me një fabrikë përpunimin e mishit e cila gjendet në Rahovec, për të cilën rrethanë është në dijeni [REDACTED]

- Në vitin 2016, Jeton Buquku së bashku me Labinot Lushaj, kanë marr Eskavatorin e llojit, Case 580, me qekiq hidraulik, 5 korpa dhe me presë të asfaltit të cilat i kishte transportuar [REDACTED] nga Franca për në Kosovë, të cilat i kishte doganuar Labinot Lushaj në Kosovë, në shumë totale prej 60.000 Euro, e pastaj i ka marr Jeton Buquku për ti hap disa kanalizime në fabrikën në Cig, dhe pas kryerjes së punëve në fabrikën në Cig, pa dijenin e Demës ia ka shit Kurbin dhe Alban Dizdarit në shumë prej 65.000 Euro. Kur Demë e ka thirr Kurbin Dizdarin dhe i ka thënë se eskavatori është i imi, Kurbin Dizdari edhe Alban Dizdari kanë thënë se na e dim qe bageri është i yti dhe kemi bo një biznes me të, kemi fitu, po nkohen ma të shpejtë kemi me ti pagu paret se jem faleminderues për ketë punë, edhe e dim që keni raporte shumë të kqija me Buquku, dhe ne kemi me pagu borxhin edhe nuk kemi me pas as një problem.

- Në vitin 2018, Labinot Lushaj, duke qenë në dijeni se [REDACTED], pronar i kompanisë [REDACTED] Group ia kishte borxh Demë Elshani shumën prej 130.000 Euro, në emër të makinerisë të blerë me priti nga Demë, shkon së bashku me Jeton Buquku dhe Labinot Elshanin, e bindin të njëjtin se me dijeni dhe marrëveshje me Demën janë të gatshëm që në emër të kësaj shume, [REDACTED] t'ia asfaltoj oborrin e fabrikës përpunimin e mishit në Cig si dhe t'ia ndërtoj vendin përr terrjen e mishit Jeton Buquku. [REDACTED] duke besuar në të njëjtit dhe duke menduar se Labinot Lushaj ende është punëtor i Demës, si dhe Labinot Elshani është kushëri i Demës, pranon dhe ia kryen punët e këruara duke pretenduar se në këtë mënyrë zbaton borxhin të cilin ia kishte Demë Elshanit.(Asfaltimi është në atë vend ku Egzon, Jeton e Enver Buquku rrejshëm kanë lajmëruar se ju kishte hedhur një bombë pa kapsollë);

Pas vdekjes së [REDACTED] nga Fsh. Qubrel i Drenicës, K. Skenderajit, shok i ngushtë i Demë Elshani që nga kohët e hershme, nga familjari i tij [REDACTED], Jeton Buquku ka shkuar dhe i ka marr 12.000 euro pa dijenin e Demë Elshani, shumë kjo të cilën [REDACTED] ia kishte

borsin Demes, para vdekjes së [REDACTED], në emër të shit – blerjes së një kamioni. (Pasi që [REDACTED] kishte jetuar në shtëpinë e Demes dhe kishte punuar në firmën e Demes dhe vëllait të Demes, [REDACTED] në Zvicër, së bashku me Labion Lushajn dhe vëllain e tij [REDACTED]. Jeton Buqku e shfrytëzon në bashkëpunim me Labion Lushajn, ju merr paret duke i mashtruar kinse e pasku dërgu Dema me i marr paret, kjo ka ndodhur në vitin 2019, kur rastësisht Dema e kontakton [REDACTED] dhe të njëjtit i tregojnë se Jetoni së bashku ju ka marr borxhin, por edhe kamionin e edhe pjesën që Dema ia kishte fal djalit të [REDACTED].

(Jeton Buqku në kallzim penal thotë se nuk ka fol me Demen prej vitit 2010 në telefon, ndërsa në e bashkëngjisim foton ku Jeton Buqku shihet me Demen në vitin 2016)- Në mars të vitit 2016, Demi Elshani e kontakton përmes telefonit Jetonin kërkon që të takohet me të dhe të zbatohen me borxhe, për çka Jeton Buqku shkon në Spanjë, në Valencia dhe diskutojnë për borxhet. Dema ia prezanton të gjitha borxhet me listë, Jetoni i thotë se sot po pjmë raki e nesër kusuritem. Dema insiston pasi që prezent ishte edhe menaxheri i tij JOSE SANCHEZ, por prap nuk bëri presion për këtë, duke konsideruar se Jetonin e ka mik. Vazhdojnë e pijen së bashku Jin tonik e pas kësaj Jetoni ka vazhduar me disa femra në dhomë, ndërsa Dema ka shkuar i vetëm në dhomën e tij.

Në po të njëjtën mbrëmje, Jetoni me Demen takohen në po të njëtin hotel, në pjesën e barit, ku Jetoni menjëherë fillon muhabetin e [REDACTED] vëllait të vogël të Demes. Jetoni insiston që të dorëzohet Graniti në Kosovë, duke thënë se unë e kam një njeri që më garanton se do e liroj menjëherë Granitin. Pas insistimit të Demes se kush është ky njëri, Jetoni i thotë Demes se është [REDACTED] dhe [REDACTED] (Drejtori i Forenzikës). Dema i revoltuar i thotë Jetonit se “Ku mundet të më bëjë hajr armiku i familjes time, ky [REDACTED], i cili përmes korupsionit i ka liruar vrasësit nga Shqipëria që e kanë vra [REDACTED], në oborrin e shtëpisë së tij” dhe [REDACTED] që i a pagu tan i ka leshu t pafajshëm edhe pse vet vrasësi e pranon veprën, bashk me [REDACTED]. Si mendon ti me ma shti armikun në shtëpinë time”.

“Ti e din se [REDACTED] (motra medicionale) me inekzion e ka mbytë [REDACTED] nga [REDACTED] vetëm pse ka tregu se kush e ka organizu dhe e ka finançu vrasjen e [REDACTED], vëllaut tim. E përmes [REDACTED] ju kanë dorëzu prokurorit [REDACTED] 100.000 Euro, pasi që e njëjtë kishte lidhje dashurie me të”.

“Ti e din edhe se [REDACTED] përmes vëllait të [REDACTED], ia ka dërgu [REDACTED] 100.000 euro, për mi liru vrasësit e [REDACTED]”

Pas këtij reagimi, Jetoni e ndërron muhabetin dhe i thotë se: “Unë dhe familja ime jemi shumë borxh te ti, pare nuk kemi, por do ishim mirënjojës nëse pranon që borxhin ta kthejmë me patundshmëri, pasuri tonën”. Dema i thotë: “se unë mund ta pranoj edhe këtë, por nuk e pranoj të më lahet borxhi me shtëpinë ku jetoni. Mund ta lani me patundshmëritë që i keni blerë nga parat që i keni marr borxh nga unë” Edhe ju fitoni boll edhe unë e marr borgjin tem se është bë boll e gjatë kjo. Demen fillon me marr gjumi dhe shkon në dhomën e tij me fjet.

Kur zgjohet Dema nga gjumi, rrëth orës 8:00, shkon me kërkua Jetonin në dhomë për me pi kafe, kur nuk përgjigjet lajmëron receptionin i shqetësuar se mos i ka ndodh diçka, ata e njoftojnë se kishte ik nga hoteli në orën 05:00 të mëngjesit. Dem e telefonon Jetonin, por i njëjti nuk i përgjigjet deri pas dite, dhe pasdite i thotë se i është dashur që të shkoj në një seminar në

Danmarkë. Dem ai thotë ti erdhe me ndjetë një javë e mu sqaru për borxhe, por Jetoni i thotë se më lajmëruan vonë dhe nuk dashtë me ta prish gjumin, por ka të kthehem, do të vje te ti.

Pas 3 (tre) ditëve Jetoni shkon në Zvicër, pikërisht në shtëpinë ku jetonte nëna [REDACTED] së bashku me [REDACTED], ish gruan e [REDACTED] dhe dy fëmijët e vegjël. Nga aty Jetoni së bashku me Blerim Elshanin dhe Labinot Elshanin – Tikun, shkojnë ta takojnë [REDACTED] dhe e bindin për mi besu [REDACTED] mu kthy në Kosovë dhe mos mi tregu Demës (Jetoni së bashku me Egzonin dhe Enverin kallxojn rrejshëm në polici se kinse rastësisht janë takuar me [REDACTED] e jo që kjo tradhi ishte përgatit mirë nga vet Jeton Buquku, Blerim e Labinot Elshani).

Provë: Foto së bashku me [REDACTED] i Fabrikën e Buqukëve në Cig.

- Në vitin 2017, Jetoni e telefonon Demën dhe i thotë se: "Nuk mundem të vij e ta laj borxhin, siç jemi marr vesh, pasi që Baba dhe Nona po dëshirojnë edhe motrave me ju dhënë hise nga banesat. A Enveri e as Egzoni nuk po e marr përgjegjësinë e borxheve që i kemi ndaj teje, e po dojnë me nda pasurinë që e kam bo prej teje si me ju pas pik prej qielli.

Pas pak Demën e thirret në telefon Egzon Buquku dhe ja shpjegon në detale borxhet që i ka marr Jetoni për bërjen e pasurisë që e shfrytëzojnë së bashku, i cili i thotë se: "Unë të përgjigjem vetëm për borxhin e pjesëve të cilat i ki pagu për Range Rover, për veturën Volkswagen Fejton, dhe për pare që ma ki pagu avokatin dhe dorëzanin në Gjermani në shumë prej 37000 Euro. Për borxhet tjera merru vesh me Jetonin".

Pas kësaj Demëa përmes telefonit e kontaktion Enver Buquku në telefon, që të mirren vesh për kthimin e borxhit. Enveri i thotë se: "Unë nuk e kam ditë se kaq shumë të ka borxh Jetoni, por unë vajzat nuk mundem mi lënë pa hise. Për borxhe merruni vesh veç me Jetonin". E Demë i përgjigjet Enverit: More Enver Buquku me pas kanë aq kollaj me ba tanë këtë pasuri e kishin bo vllaznija tu që i kanë dugojtë edhe në vend më të mirë se ti, e hala jon mbet me qat pasuni, e me qato dugojë që ju ka lon baba i juve.

Në ndërkohë Jetoni e telefonon Demën dhe i tregon se: "Egzoni e ka gjytë me vra Jetonin derisa ishin në Fabrikë bashkë me [REDACTED] me noskën [REDACTED]), të cilin Egzoni e kishte paguar për ta kërcënuar Jetonin".

Demë Elshani e njeh [REDACTED] përmes Egzon Buqukut, dhe me të ka kontaktuar vetëm përmes telefonit të Egzonit, kur Egzon Buquku ia ka kërkuar Demës 10.000 Euro për me ia dhënë [REDACTED], për ta siguruar Granitin në Burgë, si dhe 1.000 Euro që të ia blejë një xhaketë të lëkurës. Demë e thirret në telefon [REDACTED] dhe i thotë se mos u përfshij mes vëllezërve, për çka i njëjtë i thotë se të kontaktoj përmes një numri tjetër, ia ndal telefonin dhe nuk e telefonon më kurrë.

Që nga ajo kohë e deri në vitin 2018, kur është dënuar [REDACTED], Jeton Buquku e ka mbajt Demën me premtim që do shkon tek ai dhe do t'ia kthen borxhin, por kjo nuk ndodhi asnjëherë.

- Në muajin mars 2021, Demë Elshanin e njoftojnë shërbimet informative se është duke u përgatitur një plan në Turqi, që të njëjtin ta ekzekutojnë përmes Shërbimit Federal të Sigurisë së

Rusia FSB, me holmin e quajtur [REDACTED] Pak ditë më vonë, Demë Elshanin e telefonon Jeton Buqku nga Turqia dhe i thotë se një mik i tij i quajtur [REDACTED], është tezak i deshiron të flas me të. [REDACTED] përmes telefonit të Jetonin, kërkon nga Demë që të takohen me arsyetim që të ia gjej disa piktura të shtrenjta për blerje. Demë i thotë se unë piktor nuk jam, por jam një katundar dhe e di që ti je i paguar për me më ekzekut. [REDACTED] ja ndal tel, dhe më nuk e kontakton.

Pikërisht në qytetin Marbej të Spanjes, Demë Elshani përmes PERSONIT i cili është zyrtar i shërbimit informativ Amerikan – Francez, e takon [REDACTED] pikërisht në shtëpinë e Halilit ku jeton së bashku me bashkëshorten ruse dhe djalin e tij, i cili pranon se është paguar nga Jeton Buqku për ta ekzekutuar Demë Elshanin. [REDACTED] i thotë Demës se: "unë nuk kam pas për qëllim me ta marr jetën, por thjeshtë kam dashur të ndihmoj pasi që Jetoni ka bashkëpunuar me kolegë të mi, ju ka dorëzuar fotografitë tuaja, fotot e shtëpisë dhe gjithçka tjetër për ju. Unë thjeshtë kam dashur që të shpëtoj dhe njëkohësisht të përfitoj financiarisht. [REDACTED] dhe djali i tij e kanë ditë se unë do të udhëtoj për në Stamboll me Jetonin, por nuk e di a kanë qenë në dijeni për arsyen e udhëtimit tonë".

Vlen të ceket se raportet mes Demë Elshanit dhe familjes Buqku u acaruan shkaku se Jeton dhe Egzon Buqku, duke shfrytëzuar mosprezencën e Demës në Kosovë, shantazhuan dhe kërcënuan persona të ndryshëm, duke u prezantuar se janë kërkesa të ndryshme nga Demë. Si p.sh. Jetoni, Egzoni dhe Leotrim Elshani – Tiku së bashku shkojnë te [REDACTED] dhe i thonë se këtë fala nga Demë, i cili është pronar i Fabrikës së Mishit në Cig mi marr produktet tona të mishit për shitje në markete tuaja, për çka [REDACTED] i thotë se [REDACTED] e kom-njoftë mirë, kemi treguar së bashku para lufte dhe nesc djali i [REDACTED] më thotë me heq mishin tim nga marketet e miaja dhe me shit mishin e juaj unë do e bëjë atë. Por si e njoh unë [REDACTED] djali i tij nuk e bënë këtë punë kurrrë.

Gjithashtu të njëjtit shkojnë dhe e kërcënojnë [REDACTED] Shoshin i cili ishte menaxher i shumë këngëtarëve shqiptar, që i njëjti mos të lejoj që të këndojnë këngëtar në Spaceclub me pronar [REDACTED] ihe në lokalin Bashqe e cila ishte pronar e [REDACTED]

Demën e njofton [REDACTED], bashkëluftëtar, mik edhe i babait të Demës, qysh nga

Qysh nga fillimi i luftës ne Kosove daja i [REDACTED] i cili kontakton me [REDACTED] dhe përmes Alushit bisedojnë me Demen te cilët kishin raporte shumë te mira edhe me te kaluarën për të gjitha këto që po bëhen në mungesë të tij, për çka Demë e telefonon Jetonin dhe i thotë se: Mos ma keqpërdor emrin, mos ma flliq emrin, se me ditë që ti ma ngjallë Virgilin nga VARRI nuk ta lejoj me ma flliq emrin, që kemi luftu babë e babagjysh për këtë vend e për burini. Kurrë unë e as familja ime nuk kemi jetuar tu i kërcënuar njerëzit e aq më pak shqiptar që kemi luftu baba, babagjysh e katragjysh përlirin e këtij populli. E ti me vëllain tënd Egzon Qyrranin e me Leotrim Kerkushin e Blerim Elshanin që sherri i tij mu ka vra baba me dy vllazni, kishe koket bo mafioza me qit reket e me kërcënu njerëz në emrin tim. E këtë nuk ta lejoj me bo as ti me familjen tënde, tu u thirr në emrin tim.

Dema e thërret edhe Egzon Buqkun edhe i thotë qysh more ti morraq nuk ke guxu me dal në rrugë e tash tu ju qit në emën temin retet ushtarëve të UÇK-së, e qytetarëve të Pejës e të shtetit të

Kosovës. Mos keni taksirat me më përzi mu në këto matematika të juaja e lojna të fliqta e reketë. Ti edhe [REDACTED], djalit të [REDACTED] je ardh i ke marr pare te Labinot Lushajt, atje-shkonë e bëheni të ndershëm, e te unë vini i merrni edhe 200 euro, more hajna të fliqt se me emrin tem e të familje stem doni me bo emër, trimni e burrni.

Dema e thërrret edhe Leotrim Elshanin dhe i thotë se: Ti Bajrull, nuk je i zoti me tut macen prej psheshit, nuk keni pas bukë me hongër as ti e as familja jote, e ti u bone me shku mi qit reket [REDACTED]

[REDACTED], e tu i rrejt e t'ju thonë jam vëllai i Dem Elshanit. Ti je rrenc mundesh me ju thënë se je veç tradhëtarë e jani që e ka vjedh e e ka tradhëtu Demë Elshanin që ja ke vjedh pasurinë e e ke qir në prit me vra, e mos keni taksirat me përdor emrin tim o qene. Leotrim Elshni i përgjigjet se: Unë jam bashk me Naimin e krejtë Elshant, e i kemi edhe Buqukt, e asnjëni më nuk kemi nevojë për ty, e as për emrin tënd. Pastaj ja shkuat në platformën Viber se kurrë nuk ka me këndu as në Bashqe, e as te [REDACTED]. Edhe baba jem Naimi ka thonë se kurrë më nuk ka me këndu, edhe nuk ka me këndu. Dema i përgjigjet se as ti e as baba jo nuk jeni në gjendje me tu macen prej psheshit, nuk keni pas bukë me hongër, e tash po doni me ja ndal bukën tjerëve, shqiptarëve që kanë luftu për këtë vend e ju jeni ik në Ulqin more hajna.

Provë – Foto e viberit.

Pas kësaj Dema e thërrret në telefon [REDACTED] dhe i thotë se ti nuk keni të fala nga unë me ndal muzika nëpër Pejë. Angazhoj këngëtarët le të këndojnë ku të duan se unë nuk jam i përfshimë në këtë punë. Dema i thotë shko e dërgoj këngëtarët me këndu në lokal te [REDACTED] dhe te vëllezërit

Pas kësaj [REDACTED] i dërgon këngëtarët me këndu në dy lokacionet ku kërkon Dema dhe nuk ju merr përqindje për punën e menaxherit, por vetëm pagesën për këngëtar.

(Jeton Buquku në kallëzimin penal apo deklaratën e tij rren se nuk ka bisedu me Demën që nga viti 2010)

Në fillim të muajit tetor 2018 Jeton Buquku telefonon Demë Elshanin dhe i thotë: "Mos u përzgjedh mes neve dhe [REDACTED], se ai ka me hëngër prej neve, Kemi me ju qì nanën se i kemi thënë mos me ju qu muzikë [REDACTED] e as kërkuj pa izen temë. Dema i përgjigjet: O Jeton Buquku prej se të ka gjuit Egzon Buquku me të vra, je bo kogja trim e i meqem, po ku koke bo more ti mafioz, ti as shkollën fillore nuk e ki të kryme edhe nuk je more ti i zoti për këto punë. A të kujtohet kur të par rreh [REDACTED] qysh kajshe, e kur të gjuji me të vra [REDACTED], se ja ki pa re babën [REDACTED], kur më thirre në telefon qato momente kur të ka gjuit bile e je kon me mixhën tim [REDACTED] e qysh kukatshe. A je ti qai Jeton Buquku që me bab tondin Enverin nuk keni guxu me dla me ble lopë e as me pre në Pazar se u tutshit po ju vrainë shqiptart për shpiuna, e unë me babën tem e me shkoj të mi, [REDACTED] vishim me ju përcjellë nëpër masgjahe të lopëve, e tani ju koket bë reketasha e me ju qit treket ushtarëve të UÇK-së, e me pagu njerëz me vra shqiptari – shqiptarin. Po ti krejtë dynjen e ki rrejt se jemi ortak e jam i vllaznum me Dem Elshanin, e edhe sot si ti, si vllau yt e edhe fmija tu i thuani njerëzve jemi bashkë me Demë Elshanin, e ti mu kurrë ni kafe nuk ma keni pagu, bile edhe me familje tonde kur je ardh, si ti si vëllau yt, e edhe baba yt, le që edhe biletat ua kam pagu po baba yt edhe borxh 5000 Euro mi ka lyp me shku me bo marrdhënie seksuale me fëmra në Spanjë, e kurrë si keni la, more rrrena, po ku ja keni qit terezinë.

Kur u bemi trim kur t'i je qai qe kur je ardh me ndejt te unë 8 dit me Labinot Lushajn e më keni kryr tu bo sparing, si ki pa gjakun të ka ra të fikët, e e përbive gjuhën e u dashtë unë me i hek dorezat, me ta nxjerr gjuhën që e përbive e gati diqe prej tute e tash po dojke me u bo mafioz.

Pas kësaj Jeton e Egzon Buquku dhe Leotrim Elshani dërgon njerëzit pikërisht për ta rrahur [REDACTED] me arsy se nuk i është bindur urdhavrave të tij. Demën e telefonon Jeton Buquku dhe i thotë mos u përfshij në këtë punë, përcakta Dema i thotë se nëse një kime e flokut i mungon [REDACTED] keni punë me mu, dhe i kërkon borxhin. Jetoni i përgjigjet se as një cent borxh nuk ta kom.

Ku është sulmu [REDACTED] Dema e thirre Jeton e Egzon Buqukun por edhe Leotrim Elshani dhe ju thot se: E paskeni pagu qet djal jetm me i ra [REDACTED] e gati e paskeni mbytë, veç dijeni se nuk ka me ju dal mirë kjo tradhëtiswe në emrin tim e keni bo n të gjithë këtë.

Jetoni i përgjigjet nuk kemi nevojë për emrin tënd, as përti e as borxhin kurrë nuk kemi me ta la as unë e as Tiku (Leotrim Elshani), as Shkodran Hyseni, as Blerim Elshani. Ne jemi krejt bashkë e unë me babën tem jemi ma pidh nane se krejtë bota, e pak ja kem bo [REDACTED] e tash kem me vra krejtë [REDACTED]

Me dt. 14.03.2022, pikërisht në kurën kur dënohet [REDACTED], Dema e thirret Jeton Buqukun në telefon dhe i thot se: O Jeton Buquku bravo të kofte se tradhëti më e madhe hala në krejtë shqiptari nuk ju ka bo kujt, e ti që medon që i ke bo krejtë këto për me mi honger paret që të kam ndihmu me u pasuru. Ti më kë qit në të gjithë pritat, e edhe me dt. 24 Tetorkur je ardh me më thirre bashk me [REDACTED] e edhe me [REDACTED] na qove në Istog për ditlindjen tënde, e na the lejeni kerret para kafes në Ozdrim. Kur u kthyen [REDACTED] i murr 106 plumbë, e na gjuajtën edhe mu e edhe [REDACTED]. Ran edhe [REDACTED] edhe [REDACTED] Ti na kë tradhët e koke kon tradhtar me renome, e me katër vjet shkollë.

